



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2023, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR SUBVENCIONIMIN E KLUBIT FUTBOLLISTIK TË VAJZAVE “PRISHTINA”**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për subvencionimin e klubit futbollistik të vajzave “Prishtina”.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 5,000.00 € (pesë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit (biletat) për klubin futbollistik të vajzave “Prishtina”, të cilat janë ftuar për zhvillimin e dy ndeshjeve miqësore dhe dy stërvitje me trajnerët e FC “Barcelona” në Spanjë.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtorja e Sportit dhe Drejtorja e Financave.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-660/09-86554/23, më 02.05.2023

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina



## **A r s y e t i m**

### **Vendimi për subvencionimin e Klubit futbollistik të vajzave “Prishtina”**

Klubi futbollistik i vajzave “Prishtina” më, 07.04.2023 ka parashtruar kërkesën me nr. 16-400/04-73214/23, me të cilën ka kërkuar që t’iu mbulohen shpenzimet e udhëtimit (biletat) për të udhëtuar në Barcelonë.

Shuma e kërkuar nga klubi futbollistik i vajzave “Prishtina”, është 5, 000.00 € (pesë mijë euro) dhe 25 bileta nga 200 euro.

Ftesën për të udhëtuar në Barcelonë, klubi futbollistik i vajzave “Prishtina” e ka marrë nga FC Barcelona në Spanjë për të zhvilluar dy ndeshje miqësore dhe dy stërvitje me trajnerë të FC Barcelona.

Gjithashtu do të marrin pjesë në gjysmëfinalen e UEFA-së, Women Champions League, ku do të ndjekin ndeshjen mes vajzave të FC Barcelona kundër FC Chelsea në stadiumin Camp Nou.

Në kërkesën e tyre klubi futbollistik i vajzave “Prishtina”, theksojnë se kjo është një mundësi e mirë për të luajtur me ekipin më të madh të futbollit në botë, në nivel ndërkombëtar, dhe njëkohësisht mundësi e mirë që ta përfaqësojnë Kryeqytetin për herë të parë.